

**SHOQËRIA TREGTARE
"TAÇI" SH.P.K.**



VENDIM
I
ORTAKUT TË VETËM

Më datë 01.07.2004, në Selinë e shoqërisë Tregtare "TAÇI" sh.p.k., u mbajt mbledhja e ortakut të vetëm të shoqërisë, me rendin e ditës si më poshtë:

1. Prishja e Shoqërisë me likuidim.
2. Emërimi i likuidatorit.
3. Të ndryshme.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë "TAÇI" sh.p.k., procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës, prishjen e shoqërisë me likuidim. Ortaku i vetëm i shoqërisë ka shprehur vullnetin e tij për prishjen e shoqërisë nëpërmjet likuidimit të saj. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet në mbështetje të nenit 16 të Statutit të Shoqërisë dhe të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Si rrjedhojë në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria, pas emërit të saj do të mbajë detyrimisht emërtimin Shoqëri në Likuidim e Sipër.

Për pikën e parë të rendit të ditës, ortaku vendosi për prishjen e shoqërisë nëpërmjet likuidimit.

Ortaku i Vetëm duke u bazuar në pikën e dytë të rendit të ditës dhe për sa vendosi më sipër, propozon për emërim si likuidator të shoqërisë Z. Dashnor Islam Memishi, ekspert kontabël i autorizuar. Likuidatori, sipas afateve të përcaktuara nga ligji, do të hartojë bilancin financiar përfundimtar dhe aktin e likuidimit.

Për pikën e dytë të rendit të ditës, ortaku i vetëm vendosi emërimin e likuidatorit, ekspertit kontabël të autorizuar Z. Dashnor Islam Memishi.

Pas konsultimit me aktet e shoqërisë dhe me legjislacionin tregtar në fuqi, dhe duke mos patur pikë tjetër për të vendosur, Ortaku i Vetëm i shoqërisë,

VENDOSI:

1. Të prishë shoqërinë me anë të likuidimit.
2. Të emërojnë si likuidator ekspertin kontabël të autorizuar Z. Dashnor Islam Memishi.
3. Ngarkohet administratori i shoqërisë Z. Artan Gaçi për depozitimin e këtij vendimi dhe emërimin e likuidatorit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

ORTAKU I VETËM

Artan GAÇI